d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]**;

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

Blerje Ushqime për vitin 2022- Loti II- "Blerje bulmet , qumësht, kos, djath, gjizë"					
1	2	3	4	5	6
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	Afati
1.	Qumesht tetrapak	355 000			12 Muaj I MK
2.	Kos	186 500			12 Muaj I MK
3.	Djath i bardhe	6 000			12 Muaj I MK
4.	Djath kaçkavall	650			12 Muaj I MK
5.	Gjize pa kripe	23 100			12 Muaj I MK
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

1. SPECIFIKIMET TEKNIKE

Duke iu referuar Standardeve Shtetërore, Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, nr. 434, datë 11.07.2018 "Për etiketimin e ushimeve dhe informimin e konsumatorit", Urdhrave dhe Udhëzimeve në fuqi, si dhe në bashkëpunim me specialistë të "Sektorit të Ushqimit" në DPAKU, komisioni ka hartuar "Specifikimet teknike të produkteve ushqimore" si më poshtë:

1. Qumësht UHT tetrapak

Bazuar ne STASH 1563/87, Ligjin nr. 9863, datë 28.01.2008 "Për ushqimin", të ndryshuar, Udhëzimin nr. 5, datë 25.03.2011 "Për kërkesat specifike të higjenës për stabilimentet e prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të produkteve me bazë qumshti", Ligjin Nr. 9441, datë 11.11.2005 "Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumshtit dhe të produkteve me bazë qumshti".

Urdher i Ministrisë së Bujqësisë dhe mbrojtjes së Konsumatorit nr. 24, datë 30.01.2013 "Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve", Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016 " Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores "Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore", VKM nr. 434, datë 11.07.2018 "Për etiketimin e ushimeve dhe informimin e konsumatorit"

Qumësht UHT tetrapak.

Kërkesat cilësore :

Detyrimisht i pasterizuar dhe i sterilizuar.

Gjate përpunimit dhe tregtimit të zbatohen rregullat higjeno sanitare e veterinare në fuqi.

Nuk duhet të lejohet përdorimi i lëndëve konservuese, neutralizuese dhe të huaja.

Të plotësoje treguesit organo-leptikë dhe ato fiziko-kimikë.

Pamja e jashtme:

Të jetë leng homogjen, pa lende të huaja që notojnë apo precipitojnë me rrjedhje të njëllotë dhe pa ndërprerje.

Ngjyra e bardhe e njëllotë, nuance e lehte e verdhë .

Shija dhe era të këndshme, lehtësisht e ëmbël, pa shije ose ere të huaja.

Qumeshti duhet të jetë i ambalazhuar në kuti tetrapak sipas normave teknike dhe higjienosanitare nga standardet përkatëse, në peshë 1 lit.

Treguesit fiziko-kimikë (analiza fiziko-kimike):

1. Dendësia në 20 gradë celcius 1.028 – 1.034 gr/litër.
2. Pika e ngrirjes jo më e lartë se –0,520 gradë C
3. Proteina jo më pak se 28 gr/lit, e llogaritur duke shumëzuar me 6.38 përmbajtjen e azotit total të qumshtit të shprehur në %.
4. Përmbajtja e yndyrës në %, 3-3.4 %.
5. Aciditeti në grade Tjorner:
Në periudhën 01 Tetor – 31 Mars jo më e lartë se 19
Në periudhën 01 Prill – 30 Shtator jo më e lartë se 20
6. Përmbajtja e lëndës së thatë, pa yndyrë, jo më pak se 8.5 %
7. Prova e pasterizimit (e fosfatazës dhe peroksidezës) duhet negative.

Pastertia pa mbetje me site mendafshi apo merle pambuku dyfishe.

Amballazhimi brenda kushteve higjieno-sanitare, me peshë 1 lit ku të jenë vendosur:

Etiketimi: Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit .

Pesha neto ose vëllimi i produktit.

Data e skadimit.

Përqindja e yndyrës.

Temperatura e ruajtjes së produktit.

Analiza mikrobiologjike

1. Enterobacteriaceae < 10 cfu/ml
2. A. total

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rruajtja e transportimi në temperaturë 2 deri në 8 grade.

Paketimi gjatë transportit duhet të jetë në kuti kartoni (koli) me nga 6-12 kuti qumshti secila.

Malli duhet të shoqerohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.
2. Raport Analiza “Mikrobiologjike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analizat duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

2. Kos

STASH 1443-87

Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”

Kos.

Kërkesat cilësore

Të plotesoje treguesit e cilesise si me poshtë:

- Ngjyra: e bardhe, në sipërfaqe e bardhe lehtësisht në krem.
- Struktura: e ngjeshur, pa pore, në prerje pa shtresa dhe ndarje hirre.
- Era dhe shija: e këndshme, karakteristike e kosit të ëmbël, lehtësisht e thate.

Treguesit fiziko-kimikë (analiza fiziko-kimike):

- Aciditeti në grade Tjorner jo më shumë se 120

- Yndyra në % 2 ± 0.1

Analize mikrobiologjike

- Enterobacteriaceae < 10 cfu/ml

Ambalazhimi, Etiketimi dhe Markerimi

Kosi ambalazhohet në paketim tetrapak, shishe qelqi ose plastike, me grykë të gjerë, me masë 500g - 1 kg të mbyllur dhe me kapak.

Ambalazhet që përdoren të jenë në gjendje të mirë, të pastër, të thata dhe pa erë të huaj.

Materiali që përdoret për ambalazhim duhet të jetë sipas normave teknike dhe higjienosanitare nga standardet përkatëse.

Shmangiet e lejuara ndaj vëllimit nominal të kosit të ambalazhuar janë:

- ± 20 g për ambalazhet 1000 g
- ± 15 g për ambalazhet 500 g

Në çdo paketim vendoset etiketa ku shënohet:

- Emri i ndërrmarjes prodhuese
- Emri i produktit .
- Përqindja e yndyrës
- Data e skadimit
- Kushtet e vecanta të ruajtjes.
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.
- Ruajtja dhe transporti:

Kosi ruhet e tregëtohet në frigorifer në temperatura nën 10°C dhe në mungesë të tyre mbahet në mjedis të freskët dhe të ajrosur. Transporti bëhet me mjete të, mbuluara, të pastra, me mjete frigoriferike.

Paketimi gjatë transportit duhet të bëhet në kuti kartoni ose paketim qeske vakumi me nga 6-12 shishe kosi secila.

Malli duhet të shoqërohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.
 2. Raport Analiza “Mikrobiologjike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.
- Raport Analizat duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

3. Djath i bardhë

Bazuar në STASH 1410/87.

Urdhër i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”

Djath fetë (lope)

Pamja e jashtme:

Të jetë i stazhionuar jo më pak se 45 ditë, të mos jetë i falsifikuar me niseshte apo lëndë të huaja.

Ngjyra: E bardhë deri në krem.

Forma: prizëm, trekëndësh me një faqe anësore cilindrike.

Masa e formës në g, 0.5-1 kg.

Pamja e jashtme dhe e brendshme: e formuar mirë, e pastër dhe pa njolla.

Lejohen plasaritje të lehta në sipërfaqe. Në prerje është e njellojtë, e pastër, pa lëndë të huaja me sythe teknike, me ngjyrë të bardhë deri në krem.

Struktura dhe konsistenca: e lemuar, jo e fortë dhe pa dallim shtresash.

Era dhe shija: E këndshme, specifike e djathit të bute të stazhionuar, pa shije të hidhur dhe djegëse, pa shije e ere të huaj.

Treguesit fiziko kimikë (analiza fiziko-kimike):

1-Lageshtira ne %, jo me shume se:

Per periudhen 1.05- 30.09, %“52”

Per periudhen 1.10.- 30.04, %“56”

2- Lendet e thata ne %,jo me pak se

Per periudhen 1.05- 30.09, %“48”

Per periudhen 1.10.- 30.04, %“44”

3- Yndyra ne lendet e thata në %, jo më pak se % 30-60

4- Kripë në % deri 4 ± 1 .

Analiza mikrobiologjike:

E-coli 100-1000 cfu/ml

Staphylococci 10-100 cfu/ml

Ambalazhimi, Etiketimi dhe Markerimi:

Ambalzhimi duhet të jetë brenda kushteve higjieno - sanitare, i ndarë në pesha te vogla nga 0.5-1 kg, sipas kërkesave të AK.

Djathi duhet të jetë i ambalzhuar në qeska plastike me vakum. Materiali ambalzhues duhet të jetë sipas normave teknike dhe higjenosanitare nga standardet përkatëse.

Mbi çdo ambalazh me djath vendoset etiketa ne të cilen shenohen:

Etiketimi: Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit

Cilësia

Masa neto.

Data e skadencës

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyre që të mos shkëputet nga ambalazhi.

Kur djathi është i ambalazhuar në kuti kartoni tretrapack, ne kuti duhet te shenohet: emërtimi i produktit, data e skadences dhe treguesit fiziko-kimikë.

Shënimet e detyrueshme të Etiketimit duhet të jene të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret nje etikete shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Në rastin kur etiketa është zëvendësuar apo plotësuar me nje tjetër, shenimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës orgjinale.

Ruajtja dhe transporti:

Rruajtja: Ne frigorifer per 12 muaj ne temperature nga 3 deri ne 5 gradë C, lageshtia relative e ajrit 95 %.

Gjatë transportit djathi, me paketimet e kërkuara më sipër, duhet të vendoset në arka polisteroli me kapak me peshë jo më shumë se 5-10 kg secila.

Transporti i djathit bëhet me mjete frigoriferike.

Malli duhet të shoqerohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

2. Raport Analiza “Mikrobiologjike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.
Raport Analizat duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

4. Djath kaçkavall

Bazuar ne STASH 1493/87

Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”

Djath kaçkavall, (lope)

Pamja e jashtme dhe e brëndshme:

Me kore të formuar mirë dhe të pastër. Lejohen dëmtime të lehta mekanike deri në 5% të sipërfaqes. Nuk lejohen dëmtime biologjike, shenja myku, kalbëzime dhe fryrje.

Djathi kaçkavall të jetë i stazhionuar dhe i perpunuar brenda kushteve teknologjike, prodhuar me qumesht lope.

Forma: Prizem, trekendore faqe anesore cilindrike

Pamja e jashtme: E formuar mire, e paster pa njolla, pa lende te huaja.

Shija dhe era: E kendshme dhe specifike e llojit të djathit të stazhionuar, pa shije te hidhur dhe djegese dhe pa shije dhe ere te huaj.

Treguesit fizioko-kimike (analiza fiziko-kimike):

- Përmbajtja e lëndëve të thata në % jo më pak se 57- 60 %.

- Yndyrnat në lëndët e thata jo me pak se 32 - 50%

- Kripe: Deri ne 3.5% ($\pm 0.5\%$)

Analiza Mikrobiologjike

E-coli 100-1000 cfu/ml

Staphylococci 100-1000 cfu/ml

Ambalazhimi, Etiketimi dhe Markerimi:

Ambalzhimi duhet të jetë brenda kushteve higjeno - sanitare, i ndarë në pesha te vogla nga 0.5-1 kg, sipas kërkesave të AK.

Djathi duhet të jetë i ambalzhuar në qeska plastike me vakum. Materiali ambalzhues duhet të jetë sipas normave teknike dhe higjenosanitare nga standardet përkatëse.

Etiketimi: Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit

Cilësia

Masa neto.

Data e skadencës

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shpëputet nga ambalazhi.

Ruajtja dhe transporti:

Djathrat e fortë ruhen në frigorifer në temperaturë 2-4 gradëC, me lagështirë relative të ajrit 85-90%. Koha e ruajtjes në frigorifer është deri në 12 muaj.

Gjatë transportit djathi, me paketimet e kërkuara më sipër, duhet të vendoset në arka polisteroli me kapak me peshë jo më shumë se 5 – 10 kg secila.

Transporti bëhet me mjete frigoriferike.

Malli duhet të shoqerohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

2. Raport Analiza “Mikrobiologjike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analizat duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

5. Gjiza pa kripë

STASH 1424/87

Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”

Gjize e fresket dhe pa kripë.

Pamja: E pastër, me ngjyrë të bardhë, lehtësisht në gri.

Struktura : e njellojte ne te gjithë masen, pa therrime djathi.

Era dhe shija: e kendeshme, karakteristik e gjizes se fresket, lehtesishte ne te embel, pa shije thartire.

Treguesit fiziko kimikë (analiza fiziko-kimike):

1- Lageshtira ne % , jo me shume se 68

2- Yndyrë ne e %, jo me pak se 3.

Analiza mikrobiologjike

- E-coli 100-1000 cfu/ml

Ambalazhimi, Etiketimi dhe Markerimi:

Gjiza e fresket ambalazhohet ne enë plastike me mbyllje hermetike me mase 0.5 kg. Materiali ambalzhues duhet të jetë sipas normave teknike dhe higjenosanitare nga standardet përkatëse.

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit

Cilësia

Masa neto.

Data e skadencës

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyre që të mos shkeputet nga ambalazhi.

Shënimet e detyrueshme të Etiketimit duhet të jene të qarta ,të dukshme mire,të pashlyeshme dhe lehtesisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

Ruajtja dhe transporti:

Gjiza ruhet ne frigorifer ne temperature 2-4⁰C,

Gjatë transportit gjiza, me paketimet e kërkuara më sipër, duhet të vendoset në arka polisteroli me kapak me peshë jo më shumë se 5 -10 kg secila.

Transportimi i gjizes behet me mjete frigoriferike.

Malli duhet të shoqerohet me Raport Analiza të kryera nga laboratorë të akredituar, sipas legjislacionit në fuqi.

Raport analizat e kërkuara:

1. Raport Analiza “Fiziko-Kimike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

2. Raport Analiza “Mikrobilogjike” e cila duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Raport Analizat duhet të paraqiten në original, ose fotokopje të noterizuara.

Informacion argumentues për hartimin e specifikimeve teknike.

Për hartimin e specifikimeve teknike është patur parasysh, natyra e përdorimit të produkteve ushqimore si produkte ushqimor në përbërje të menusë së miratuar me Urdhërit nr. 76/1, datë 24.01.2018 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, dhe Urdhërit nr. 457, datë 13.06.2018, Për një ndryshim të Urdhrit nr. 76/1, datë 24.01.2018 “Për miratimin e

ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët 0-6 vjeç”, Hartimi i specifikimeve teknike, nga ana e Komisionit, është kryer duke iu referuar:

- Standardeve Shtetërore në fuqi STASH, për çdo artikull.
- Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar,
- VKM nr. 434, datë 11.07.2018 “Për etiketimin e ushimeve dhe informimin e konsumatorit”,
- Udhëzimin nr. 5, datë 25.03.2011 “Për kërkesat specifike të higjenës për stabilimentet e prodhimit, grumbulimit dhe përpunimit të produkteve me bazë qumshti”,
- Ligjin Nr. 9441, datë 11.11.2005 “Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e qumshtit dhe të produkteve me bazë qumshti”.
- Urdher i Ministrisë së Bujqësisë dhe mbrojtjes së Konsumatorit nr. 24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”,
- Urdher i Ministrisë së Bujqësisë Nr 645, dt. 23.12.2016 “ Për zëvendësimin e aneksit I, të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014, Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”,
- Udhëzimin nr. 21 datë 25.11.2010 të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit bazuar në Urdhërin e Ministrisë së Bujqësisë Nr. 645 datë 23.12.2016, Për zëvendësimin e aneksit I të Urdhërit nr. 234, datë 20.05.2014 Për miratimin e rregullores “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”,
- Udhëzimin nr. 15, datë 09.09.2021 i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “për Kriteret Mikrobiologjike për produktet ushqimore.
- Gjithashtu, specialistë të DPÇK kanë realizuar takime dhe kanë qenë në bashkëpunim të përhershëm edhe me specialistë të “Sektorit të Ushqimit” në DPAKU, dhe ISUV, nga ku janë detajuar me korrektesë dhe profesionalizëm kërkesat ligjore për specifikimet teknike dhe kërkesat për sigurinë ushqimore të produkteve ushqimore.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Loti II: "Blerje bulmet , qumësht, kos, djath, gjizë"			
Nr	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Qumesht tetrapak	Litra	355,000
2	Kos	Kg	186,500
3	Djath i bardhe	Kg	6,000
4	Djath kaçkavall	Kg	650
5	Gjize pa kripe	Kg	23,100

Afatet e lëvrimit:

Afati i lëvrimit të mallrave do të jetë që nga data e lidhjes së kontratës deri në përfundim të periudhës 12 mujore të Marrëveshjes Kuadër.

Mënyra e Lëvrimit:

- Malli do të lëvrohet çdo ditë të javës nga e Hëna në të Premte.
- Dita e Shtunë, e Diel si dhe festat zyrtare janë pushim.
- Sasia e mallit që do të lëvrohet, do të kërkohet nga Autoriteti Kontraktor çdo ditë, në bazë të përlogaritjeve ditore, duke iu referuar frekuentimit ditor të femijeve dhe menuesë ushqimore të çerdheve dhe kopshteve publike të Tiranës, sipas normativave të miratuara.

Kushtet e lëvrimit:

- Mallrat do të lëvrohen me automjetet e Subjektit Kontraktor në magazinën e Autoriteti Kontraktor.
- Furnizimi do të kryhet çdo ditë duke filluar prej orës 07:30 deri në orën 09:00.
- Çdo ditë, në momentin e lëvrimit të mallrave pranë magazinës së Autoriteti Kontraktor duhet të jetë i pranishëm një përfaqësues i Subjektit Kontraktor ose një person i autorizuar prej tij. Prania e përfaqësuesit të sipërshtuar përbën kusht për marrjen e mallit në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1. Kopje të çertifikuara të balanceve vjetore të paraqitura pranë autoriteteve tatimore perkatese për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku bilancet e kërkuar nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.
- 2.2.2. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.
Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatorëve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.
 - Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.
 - Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat, sasi dhe llojin e mallrave të furnizuara.
- 2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë Certifikatë ISO 9001-2015, ISO 22000: 2018 ose ekuivalente me to, të vlefshme.
Në rastin e BOE certifikatat duhet të paraqiten nga secili prej anëtarëve të BOE.
- 2.3.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetëdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, ku të deklarojë se disponon të paktën 5 punonjës në

momentin e deklarimit dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës marrëveshje kuadër.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** duhet të paraqesë listëpagesen e deklaruar përmes formës elektronike, ku te specifikohet numri i punonjesve.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon mjet transporti ATV frigoriferik, ne pronësi ose ne përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës marrëveshje kuadër.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon mjetin e transportit ATV frigoriferik, ne pronësi ose ne përdorim sipas kontratës noteriale, të vertetuar me:

- leje qarkullimi,
- certifikate pronësie
- siguracion (TPL)
- certifikatë e kontrollit teknik

2.3.5. Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë licence me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas objektit të prokurimit:

Për OE/BOE vendas:

Licence leshuar nga Qendra Kombetare e Biznesit (QKB) me kategoritë e mëposhtëme:

Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.

Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.

Për OE/BOE e huaj:

Operatori ekonomik duhet të disponojë licencë të vlefshme për veprimtarinë e ushtruar sipas kërkesës së mësipërme, të lëshuar nga autoritetet përgjegjëse të vendit të origjinës. Në këtë licencë duhet të jetë qartësisht e dallueshme veprimtaria përshkruese sipas këtij kriteri.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standardet respektive në fuqi për sigurinë ushqimore.

Për OE/BOE vendas:

Për këtë OE duhet të paraqesë vetëdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i kryer nga autoritetet në subjektin e tij, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Vetdeklarimi duhet të përmbajë datën dhe numrin e procesverbalit të kontrollit të fundit të AKU.

OE i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** ka për detyrim të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, si dhe dokumentacionin provues të kontrollit të AKU në periudhën e vetdeklarimit.

Për OE/BOE e huaj:

Vetdeklarimi i paraqitur për plotësimin e këtij kriteri duhet të përshkruaj qartësisht:

- institucionin që ka ushtruar kontrollin përkatës në vendin e origjinës dhe website-in zyrtar të institucionit;
- datën e lëshimit të këtij dokumentacioni;

OE i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** ka për detyrim të paraqesë dokumentacionin provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i institucionit përkatës në vendin e origjinës, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, si dhe dokumentacionin provues të kontrollit të institucionit përkatës në periudhën e vetdeklarimit.

Ky dokumentacion duhet të paraqitet, i noterizuar dhe i certifikuar me vulë “Apostile”.

2.3.7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një mostër për çdo artikull të kërkuar sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor dhe dëshmitë e testimeve zyrtare të dorëzuara në SPE.

Mostrat e kërkuara do paraqiten në datën dhe orën e hapjes së ofertave, pranë DPÇK me adresë Rr. e Barrikadave, Çerdhja nr.1 Tirane.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë e cila të përmbajë elementet: mostër “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Mungesa e mostres është kusht skualifikues.

2.3.8 Oferta, dëshmitë e rezultateve të testimeve zyrtare, ankesat, në të gjitha fazat e procedurës prokurimit, kërkesat për sqarim dhe çdo dokumentacion tjetër i kërkuar në DST duhet të jetë **shqip ose anglisht**.

Në rastin e Operatorëve Ekonomikë të huaj, i gjithë dokumentacioni i sipërpërmendur në përmbushje të kriteve, duhet të paraqitet në SPE, i noterizuar dhe i certifikuar me vulë “Apostile”.

2.3.9 Në rastin kur OE mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjerë, referuar Shtojcës Nr.8, duhet të deklarojë në mënyrë të qartë:

- **(Emri (at) e subjekteve mbështetëse;**
- **NIPT-i i subjektit/eve mbështetëse;**
- **Llojin e kapacitetit/eve teknike.**

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar duhet të paraqitet në origjinal ose kopje e noterizuar e njësuar me origjinalin.

Në rastin e Operatorëve Ekonomik të huaj i gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet, i noterizuar dhe i certifikuar me vulë “Apostile”.

Për vendet që e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për ”Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, dokumentet e lëshuara duhet të përmbajnë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

Për vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për ”Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e ketyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. Mosparaqitja e dokumentacionit në këtë formë është kusht s’kualifikues.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar, ose paraqitja e dokumentave të rreme, përbën kusht për skualifikim.

Informacion argumentues mbi hartimin e kriterëve teknike të kualifikimit:

- Në kriteret teknike të kualifikimit nga ana e komisionit është kërkuar që OE duhet të disponojë Certifikata ISO si më poshtë:
Certifikate ISO 9001-2015, ose ekuivalente me të, të vlefshme.
Kjo është certifikatë për “Sistemin e menaxhimit të cilësisë” së produkteve.
Certifikatë ISO 22000:2018 ose ekuivalente me të, të vlefshme për sistemin e menaxhimit të sigurisë ushqimore.
Pajisja me këto certifikata ISO, garanton që OE konkurohet plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve ushqimore që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm si dhe plotëson kërkesat për një sistem të administrimit të sigurisë ushqimore.
- Komisioni ka kërkuar që OE duhet të të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon të paktën 5 punonjës në momentin e deklarimit dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës marrëveshje kuadër. Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të paraqesë listëpagesen e deklaruar përmes formës elektronike, ku të specifikohet numri i punonjesve
Ky kriter është vendosur në funksion të zbatimit të kontratës, me qëllim përmbushjen e nevojave për furnizimin e vazhdueshëm, të përditshëm e të pandërprër të DPÇK me artikujt objekt prokurim. Në funksion të sa më sipër minimalisht nevojiten: 2 shoferë, 1 furnitor, 1 magazinier dhe 1 ekonomist.
- Komisioni ka kërkuar vetdeklarimin sipas shtojcës 8 të DST, Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, ku të deklarojë se disponon mjet transporti ATV frigoriferik, ne pronësi ose ne përdorim, në momentin e deklarimit si dhe përgjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës marrëveshje kuadër.
Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin që disponon mjetin e transportit ATV frigoriferik, ne pronësi ose ne përdorim sipas kontratës noteriale, te vertetuar me:
 - leje qarkullimi,
 - certifikate pronësie.
 - Sigurancë TPL
 - Certifikatë e kontrollit teknikArsyeja përse është kërkuar automjeti ATV është bërë duke marrë parasysh kushtet në të cilat duhet të kryhet transporti i produkteve. Duke iu referuar Ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, për transportin e këtyre produkteve kërkohen kushte frigoriferike, për rrjedhojë, automjetet kërkohen të jenë frigoriferikë, d.m.th ATV.
- Komisioni ka kërkuar që OE konkurohet duhet të disponojë Licencë të lëshuara nga QKB:
Kategoria: II.1 Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve.
Nënkategoria: II.1.A.1. Prodhim, përpunim, shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz.
Kjo është Licencë bazë për Prodhimin/tregëtimin e ushqimeve për njerëz, referuar Ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009, për Liçensat, Autorizimet dhe Lejet në RSH, si dhe Informacionit mbi Liçensat, Autorizimet dhe lejet, në faqen zyrtare të QKB.
- Komisioni ka kërkuar që Për këtë OE duhet të paraqesë vetdeklarim, ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit i kryer nga autoritetet në subjektin e tij, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore. Vetdeklarimi duhet të përmbajë datën dhe numrin e procesverbalit të kontrollit të fundit të AKU.
OE i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka për detyrim të paraqesë dokumentacionin provues ku të provohet se nga kontrolli i fundit i AKU, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, si dhe dokumentacionin provues të kontrollit të AKU në periudhën e vetdeklarimit.

Për OE/BOE e huaj:

Vetdeklarimi i paraqitur për plotësimin e këtij kriteri duhet të përshkruaj qartësisht:

- institucionin që ka ushtruar kontrollin përkatës në vendin e origjinës dhe website-in zyrtar të institucionit;
- datën e lëshimit të këtij dokumentacioni;

OE i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ka për detyrim të paraqesë dokumentacionin provues, ku të provohet se nga kontrolli i fundit i institucionit përkatës në vendin e origjinës, ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore, si dhe dokumentacionin provues të kontrollit të institucionit përkatës në periudhën e vetdeklarimit.

Ky dokumentacion duhet të paraqitet, i noterizuar dhe i certifikuar me vulë "Apostile".

Kjo kërkesë i referohet shkresës të APP nr. 10181 prot, datë 19.11.2018, "Për rekomandime mbi hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi dhe specifikimeve teknike për prokurimin e ushqimeve", referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis Agjensisë së Prokurimit Publik dhe AKU.

Komisioni ka kërkuar që OE duhet të paraqesë një mostër për çdo artikull të kërkuar sipas specifikimeve teknike të Autoritetit Kontraktor dhe dëshmitë e testimeve zyrtare të dorëzuara në SPE.

Mostrat e kerkuara duhet të kenë një etikete e cila të përmbajë elementet: moster "emri i artikullit", datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nenshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik.

Mungesa e mostres është kusht skualifikues.

Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", nenit 40, pika 6/a. Kriteri i vendosur për paraqitjen e mostrave është kërkuar për të vërtetuar lidhjen midis OE konkurrues në raport me mostrën e paraqitur ditën e hapjes së tenderit dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitur në SPE (dëshmitë e testimeve zyrtare), për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit. Gjithashtu për të vërtetuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike përsa i përket treguesve organo-leptik, fiziko kimik dhe mikrobiologjik.

Komisioni ka kërkuar që oferta, dëshmitë e rezultateve të testimeve zyrtare, ankesat, në të gjitha fazat e procedurës prokurimit, kërkesat për sqarim dhe çdo dokumentacion tjetër i kërkuar në DST duhet të jetë **shqip ose anglisht**. Në rastin e Operatorëve Ekonomikë të huaj, i gjithë dokumentacioni i sipërpërmendur në përmbushje të kriterëve, duhet të paraqitet në SPE, i noterizuar dhe i certifikuar me vulë "Apostile". **Kjo kërkesë është vendosur referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", nenit 24, pika 2.**

Komisioni ka kërkuar që në rastin kur OE mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjerë, referuar Shtojcës Nr.8, duhet të deklarojë në mënyrë të qartë:

- **(Emri (at) e subjekteve mbështetëse;**
- **NIPT-i i subjektit/eve mbështetëse;**
- **Llojin e kapacitetit/eve teknike.**

Kjo kërkesë është vendosur referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", nenit 90.

Informacion argumentues për fondin limit:

Referuar Informacionit për llogaritjen e sasisë së planifikuar për blerje "Artikuj Ushqimore" për Çerdhet dhe Kopshtet e Tiranës për periudhën 12 mujore të Marrëveshje Kuadër.

Për vendosjen e çmimit Komisioni është bazuar në Proçes - Verbalin e Testimit të Tregut me çmimin mesatar të testimit të tregut. Duke marrë në konsideratë situatën e vështurë aktuale komisioni i është referuar dhe raporteve mujore nga INSTAT. Rritja e çmimeve sipas raporit nga INSTAT për 4 artikujt e kësaj procedure prokurimi kanë pësuar rritje që prej 3 muajve të katert të vitit 2021, duke arritur nivele akoma dhe më të larta në Janar 2022. Për Artikullin Qumesht Tetrapak i jemi referuar vetëm Testimit të tregut pasi ky artikull nuk është në listën e raportuar nga INSTAT.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I.Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	_____
Numri NIPT/et:	_____
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	_____
Përfaqësuesi (emri):	_____
Telefoni:	_____
E-mail:	_____

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:			
• Informacione për nënkontraktorin			
Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

